



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01 Nr. 16-25014 /2015  
Kaçanik, 31. 07. 2015

Në bazë të nenit 53.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 31 korrik, 2015, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

1. Me këtë Vendim, Pranverë Loku, caktohet anëtare e Komitetit për Komunitete, në vend të Kadri Krivenjeva.
2. Caktimi i anëtares si në pikën 1. të këtij Vendimi bëhet pasi që anëtari i mëparshëm, Kadri Krivanjeva, me dëshirën e vet është tërhequr nga ky komitet.
3. Mandati i anëtares si në pikën 1. të këtij Vendimi është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës, ndërsa fillon nga dita e marrjes së këtij Vendimi.
4. Anëtari i përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi do t'i ushtroj të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si në dispozitat ligjore që e rregullojnë çështjen e Komitetit për Komunitete.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; Kryetari i Komunës.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:** Pranverë Loku, Kadri Krivenjeva, Kryetari i Komunës, Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Komiteti për Politikë dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi.



Kryesuesi i kuvendit,  
Xhelal Gashi